



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 44 (827691)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 6 Nëntor 2020

Gjeneralmajor Bajram Begaj takon atasheun ushtarak francez



Gjeneralmajor Begaj: Franca ka dhënë kontribut në modernizimin e FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneral major Prof. Asoc. Bajram Begaj, zhvilloi me 30 tetor 2020, një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Francës së akredituar në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda. Takimi u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformave online, në kuadër të masave anti-COVID19

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi bashkëpunimin dypalësh të deritanishëm midis Shqipërisë dhe Francës në fushën e mbrojtjes, duke falenderuar për mbështetjen që Franca ka dhënë në modernizimin e FARSH me helikopterë dhe trajnimin e personelit me kurset e ofruara. Nga ana e tij, atasheu ushtarak... >>> faqe 4

BIBLIOTEKA E AFA

Biblioteka e Akademisë pasurohet me 220 tituj dhe 600 kopje librash



>>> faqe 3

Rihapen pas 10 vjetësh studimet universitare në Akademinë e FA Xhaçka: Synojmë që Akademinë ta ngremë në nivelin e vendeve të NATO-s

Për të studiuar në Akademinë e FA aplikuan rreth 600 të rinj e të reja, por vetëm 60 prej tyre u përzgjedhën. Mes fituesve 13 janë vajza >>> faqe 2



Stërvitja "Defender Europe 2021"

Amerikanët testojnë bazat ushtarake të Shqipërisë

Përreth një javë oficerë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës Amerikane në Europë, zhvilluan vizita njohëse në bazat apo rajonet stërvitore të vendit, ku është parashikuar të zhvillohet stërvitja "Defender Europe 2021". Stërvitja ndërkombëtare "Defender Europe 2021" pritet të zhvillohet pranverën e ardhshme dhe do shtrihet...



>>> faqe 4

Marrin pjesë forcat ushtarake britanike

Fillon stërvitja "Rural Surveillance and Patrol Training"

Në ambientet e Repartit 1050, Zall-Herr, Tiranë u zhvillua ditën e martë më 3 nëntor 2020, ceremonia e fillimit të stërvitjes "Rural Surveillance and Patrol Training". Në këtë ceremoni, mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti dhe përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore. Kjo stërvitje kryhet midis batalionit të Forcave Speciale Shqiptare... >>> faqe 5

Ministria e mbrojtjes, Shekerinska

Buxheti i mbrojtjes 2021: 20 për qind për modernizimin e ushtrisë

>>> faqe 12

AMBASADA AMERIKANE NË TIRANË

FA po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e lëndëve shpërthyesë

faqe 4

QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

Certifikohen 56 kursantë në Kursin 67-të fillestar të nënoficerëve

faqe 6





Akademia e Forcave të Armatosura ka rihapur pas 10 vjetësh ndërprerje studimet në nivel bachelor. 60 të rinj e të reja fitues, nisën këtë të hënë studimet në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Akademia e Forcave të Armatosura ka çelur këtë të hënë, më 2 nëntor 2020, dyert për 60 studentë fitues, nga 600 aplikantë të cilët shprehën ambicie për të ndjekur studimet ushtarake. 60 studentët fitues që nisin udhën e tyre të dijes pranë Akademisë së Forcave të Armatosura do të ndjekin studimet e programit bachelor në Fakultetin e Shkencave Ushtarake. “Mirënjohje e vlerësim për të gjithë pedagogët, bashkëpunëtorët dhe stafin e Akademisë së Forcave të Armatosura, të cilët shënuan këtë moment të rëndësishëm për arsimimin e brezit të ri”, - u shpreh ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, gjatë aktivitetit të zhvilluar mëngjesin e sotëm në kampusin e Universitetit të FA ku u uroi atyre vit të suksesshëm. Në ceremoninë në fjalë mori pjesë dhe ministrja e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Evis Kushi.

Në fjalën e tij, ish pedagogu i Akademisë së Forcave të Armatosura, Kostaq Karoli, u shpreh se angazhimi në FA është një përgjegjësi e madhe. “Jetojmë në një kohë të vështirë për shkak të pandemisë dhe ndërmarrja e kësaj rruge mbart përgjegjësi dhe sakrificë. Ju uroj suksese si pedagogëve, ashtu edhe studentëve që nisin këtë rrugëtim”, - tha Karoli.

“Kjo ditë do ngelet e shënuar në FA, pasi kurorëzohet përpjekjet për ngritjen e një sistemi arsimor në harmoni me ambiciet e FA. Për herë të parë këtë vit, studimet do të kryhen plotësisht të organizuara në bazë të arsimit të lartë me një kurikul të pasur për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, i akredituar në ciklin Bachelor. Për të mbërritur këtu është dashur punë e sakrificë, e cila do të përkthehet në formësimin e të ardhmes së FA”, - u shpreh më tej, shefi i SHPA, gjeneral major Bajram Bega.

Ministrja e Arsimit, Rinisë e Sportit u shpreh se ky është një moment shumë i veçantë, pasi bëhet fjalë për një institucion prestigjioz, një strukturë e rëndësishme që do përgatisë brezat e ardhshëm në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. “Çdo studentë, është një aset i së ardhmes në fushën e mbrojtjes. 60-studentëve dhe pedagogëve u uroj shumë suksese dhe mbarësi gjatë vitit akademik. Ky fillim viti akademik, është sfidues, si asnjë vit tjetër më parë për shkak të pandemisë COVID 19. Nuk është aspak e lehtë për mua sot të uroj vitin e ri akademik në auditorë të zbrazura.

RIHAPEN PAS 10 VJETËSH STUDIMET UNIVERSITARE NË AKADEMINË E FA

Xhaçka: Synojmë që Akademinë ta ngremë në nivelin e vendeve të NATO-s

Për të studiuar në Akademinë e FA aplikuan rreth 600 të rinj e të reja, por vetëm 60 prej tyre u përzgjedhën. Mes fituesve 13 janë vajza



Por kjo është një sakrificë që duhet bërë për të mirën e përbashkët. Janë rrethana që nuk duhet t'i shmangim, por t'i përballim me kurajo”, - u shpreh ministrja Kushi.

“Akademia na krijon sot një mori mundësish që deri dje, as që nuk i mendonim dot, jo vetëm për përgatitjen e kadrove drejtuese, por edhe për afrimin drejt FA të rinjve dhe të reja me të talentuar. Është një gjë t'i kërkojmë djemve dhe vajzave që kanë mbaruar shkëlqyer shkollën e mesme. për t'iu bashkuar FA, dhe është tjetër

që t'u kërkojmë atyre që të bëhen pjesë e një universiteti që të jep mundësi që në bazë të meritës të jesh pjesë e strukturës së sigurisë dhe mbrojtjes së vendit tonë me mundësi të pafundme punësimi si brenda ashtu dhe jashtë vendit, në sajë të aleancës me NATO-n”, - tha Xhaçka.

Sipas saj, sfida e vërtetë nis tani, sepse sado e vështirë ishte rihapja e akademisë, rikthimi i saj në një histori suksesi nuk do jetë e lehtë, por janë të gjitha mundësitë, të gjithë profesionistët e duhur për ta ngritur atë në nivelin e

një akademie të NATO-s”, - nënvizoi Xhaçka. “Mbyllja e universitetit të FA ishte një nga gjëmat më të pakuptueshme të tranzicionit. Akademia u mbyll vetëm 1 vit pasi u anëtarësuam në NATO, ndërkohë që rruga e një force moderne dhe profesioniste kalon nga Akademia”, - tha ministrja e Mbrojtjes. Ajo falënderoi SHBA, Turqinë, Greqinë, Italinë e Anglinë për ndihmën në arsimim gjatë këtyre viteve dhe shtoi se “armatimet e pajisjet janë pesë me hiç nëse nuk investojmë tek njerëzit tanë. Pas disa vitesh, rihapja e Akademisë së FA do të shihet si një nga momentet kyçe të ringritjes së FA”, - përfundoi Xhaçka.

Për të studiuar në Akademinë e FA aplikuan rreth 600 të rinj e të reja, por vetëm 60 prej tyre u përzgjedhën. Mes fituesve 13 janë vajza.



Rruga e profesionalizimit ushtarak kalon nga Akademia

Akademia e FA rihap dyert për studentët ushtarakë

Fjala e ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka me rastin e rihapjes së studimeve në Akademinë e FA/ 2 nëntor 2020

Kur filluam diskutimet për ringritjen e Akademisë së FA, dita kur kjo akademi do të hape dyert për studentët e saj të parë, dukej shumë e largët. Është e vështirë të imagjinosh sesa shumë punë, sa shumë përkushtim e vendosmëri është dashur nga të gjithë ata që punuan për të realizuar këtë projekt, për të ardhur tek kjo ditë.

Dhe dua të marr një moment t'i falënderoj sërish për gjithçka kanë bërë.

Nga gjithë gjëmat që kanë përjetuar FA gjatë dekadave të tranzicionit, mbyllja e Akademisë së FA është për mua më e pakuqshme. Nuk e kam kuptuar dot kurrë sesi dikush, një ministër, një qeveri, një forcë politike, mund të fliste në njërin anë për ringritjen e ushtrisë, e nga ana tjetër të mbyllte Akademinë. E aq më pak mundem ta kuptoj sesi kjo mund të ndodhte vetëm një vit pasi Shqipëria ishte pranuar si anëtare e NATO-s. I them këto, jo sepse dua të merrem me mënyrën sesi janë rrënuar FA në të shkuarën, por sepse dua ta bëj të qartë për të gjithë ata që kanë punuar për hapjen e akademisë, për ata që do të japin mësim në akademi dhe sidomos për ata që do të ndjekin studimet këtu, se çfarë rëndësie të jashtëzakonshme ka ky institucion për FA.

Nëse ne duam të ndërtojmë një forcë moderne, nëse duam të ndërtojmë një forcë profesioniste dhe mbi të gjitha nëse duam të ndërtojmë një forcë të ngritur jo mbi mikun e tarafin e mbështetjen politike, por mbi meritokracinë, rruga kalon nga Akademia. Është e pamundur të ndërtojmë një forcë të standardeve të NATO-s në qoftë se na duhet vazhdimisht të mbështetem tek bujaria e partnerëve dhe aleatëve për të përgatitur oficerët tanë. Sigurisht që specializimet, studimet, kualifikimet, trajnimet me aleatët do të vazhdojnë dhe, këtu gjej rastin të falënderoj nga zemra mbi të gjitha Shtetet e Bashkuara, Turqinë, Greqinë, Italinë e Anglinë, të cilat na kanë ndihmuar shumë për të plotësuar këtë boshllëk të madh, që e ka bërë akoma më të vështirë procesin e modernizimit e profesionalizimit të FA, por është e pamundur të ndërtojmë një forcë të aftë për t'u përballur me sfidat e sigurisë me të cilat na përball epoka ku jetojmë, të aftë për të përmbushur pritshmëritë e aleatëve ndaj FA, në qoftë se nuk kemi mundësinë të përgatisim vit pas viti, në një institucion të mirëfilltë e të akredituar të arsimit të lartë, djemtë e vajzat më të mirë e më të talentuar për të shërbyer në FA!

E kam thënë shumë herë dhe e përsëris edhe këtu: armatimet, infrastruktura, pajisjet, sistemet, të gjitha kanë rëndësi. Por të gjitha këto janë pesë me njëri në qoftë se ne nuk investojmë tek njerëzit tanë!

Unë jam e bindur që disa vjet nga sot, kur nga kjo Akademi të kenë dalë disa breza oficerësh e drejtuesish, ne do të hedhim vështrimin pas dhe do ta identifikojmë këtë moment, si një nga momentet kyçe të ringritjes së FA dhe jam e bindur po ashtu, që ata të rinj e të reja, që fillojnë sot arsimimin në Akademinë e FA do të jenë nesër ata, që do të marrin stafetën e modernizimit e profesionalizimit të FA duke e bërë këtë proces të konsoliduar e të pakthyesëm.



Akademia na krijon sot një mori mundësish që deri dje as nuk i mendonim dot, jo vetëm për përgatitjen e kuadrove drejtuese, por edhe për afrimin drejt FA të të rinjve dhe të rejave më të talentuara. Sepse, është një gjë t'u kërkosh djemve e vajzave, që kanë mbaruar shkollën me nota të shkëlqyera të bëhen pjesë e një strukture problematike, me mundësi karriere të paqarta, dhe është tjetër gjë t'i ftohet ata

të bashkohen me FA, kur rruga e tyre kalon nga studimet në një institucion të akredituar të arsimit të lartë, i vetmi në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, kur struktura ku i fton të kontribuojnë ngrihet mbi bazat e meritokracisë dhe kur diploma që ti u ofron u jep mundësi të jashtëzakonshme punësimi e karriere jo vetëm në FA e Shqipëri, por kudo në strukturat e NATO-s!

Unë jam vërtet krenare që sot Aka-

demia më në fund rikthehet prapë duke plotësuar një boshllëk, që e kemi ndërjerë jo pak e që ka krijuar jo pak kosto për FA. Por sfida e vërtetë, në fakt, fillon vetëm tani, sepse sado e vështirë ishte rihapja e Akademisë, menaxhimi i saj profesional dhe kthimi i saj në një histori suksesi, ka për të qenë një sfidë jo e lehtë. Ama i kemi të gjitha mundësitë. Kemi kuadrot dhe profesionistët, që dinë ta bëjnë më së miri

atë që pritet nga Akademia, por kemi edhe mundësi shumë të mëdha për të përfituar mbështetjen e aleatëve, për të zgjeruar programet e saj e për ta ngritur atë në nivelin e një akademie të një vendi të NATO-s.

Mezi e kishim pritur këtë ditë, kur kjo Akademi do të hape dyert e saj. Por t'ju them të drejtën, kurrë nuk e kisha imagjinuar që hapja e dyerve të kësaj shkolle me një histori kaq të pasur, do të ndodhte në kushte të tilla, mes një pandemie që s'na lejon më as të futemi fizikisht në ambientet e kësaj ndërtese. Për këtë më vjen vërtet keq, por jam e bindur, që edhe pse do të na i bëjë punën pak më të vështirë, sigurisht që shkolla do të vazhdojë ashtu si në çdo universitet tjetër, duke u përshtatur me situatën ku ndodhemi.

Nëse kam mësuar një gjë nga drejtuesit e FA, është që një ushtarak i mirë duhet të jetë fleksibël dhe të dijë gjithmonë të përshtatet me çdo surprizë e të papritur që mund t'i dalë përpara. Prandaj, le ta shohim edhe këtë fillim kaq të pazakontë të vitit shkollor si një sprovë më tepër për të gjithë ne.

BIBLIOTEKA E AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Biblioteka e Akademisë pasurohet me 220 tituj dhe 600 kopje librash

Shumica e titujve të dhuruar nga Akademia e Shkencave trajtojnë tema historike për popullin tonë dhe gjuhën shqipe

Biblioteka e Akademisë së Forcave të Armatosura pasurohet në prag të nisjes së vitit të ri akademik, i cili pas një shkëputje 10-vjeçare do të presë kadetët për të ndjekur ciklin bachelor për shkencë ushtarake.

Akademia e Shkencave dhuroi më 30 tetor 2020, 220 tituj dhe rreth 600 kopje librash, të cilët i shtohen fondit prej 8 mijë titujsh të Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka falënderoi Akademinë e Shkencave dhe kryetarin e saj për këtë kontribut në prag të nisjes së vitit të ri akademik. Sipas saj, pandemia e kohët e vështira, që po jetojmë nuk duhet të jenë pengesë për të orientuar përherë e më shumë brezin e ri dhe oficerët e FA drejt librit e dijës. "Nuk ka investim më të rëndësishëm sesa investim të dija, pavarësisht se sa të mira janë pajisjet, apo sa të mëdha janë buxhetet tona. Nëse nuk kemi një forcë të mirëarsimuar, mirëtrajnuar e profesioniste për t'u përballur me sfidat e sotme, nuk do t'ia dalim të jemi një vend aleat me të gjitha kapacitetet." - u shpreh ministrja Xhaçka. Kryetari i Akademisë së Shkencave, pro-



fesor Skënder Gjinushi u shpreh se institucioni, që ai drejton e ka në politikën e tij që të dhurojë botimet e veta dhe shprehu kënaqësinë e veçantë që këtë kontribut ia dhurojnë, siç u shpreh ai, një institucioni kaq prestigjioz si Akademia e Forcave të Armatosura.

Titujt e dhuruar janë botime të Akademisë së Shkencave dhe do të ndihmojnë në formimin profesional dhe kulturor të ushtarakëve të rinj. Shumica e titujve të dhuruar trajtojnë tema historike për popullin tonë dhe gjuhën shqipe.

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ TAKON ATASHEUN USHTARAK FRANCEZ

Gjeneralmajor Begaj: Franca ka dhënë kontribut në modernizimin e FARSH

Gjeneralmajor Bajram Begaj, zhvilloi një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Francës së akredituar në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneral major Prof. Asoc. Bajram Begaj, zhvilloi me 30 tetor 2020, një takim me atasheun ushtarak të Republikës së Francës së akredituar në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda.

Takimi u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformave online, në kuadër të masave anti-COVID19

Gjeneralmajor Begaj vlerësoi bashkëpunimin dypalësh të deritanishëm midis Shqipërisë dhe Francës në fushën e mbrojtjes, duke falenderuar për mbështetjen që Franca ka dhënë në modernizimin e FARSH me helikopterë dhe trajnimin e personelit me kurset e ofruara.

Nga ana e tij, atasheu ushtarak francez, Kolonel Duda, vlerësoi rolin dhe kontributin e FARSH në misionet ushtarake ku dy vendet kanë trupa të përbashkët, kontributin e Shqipërisë me personel në Korpusin e Reagimit të Shpejtë (RRC-FRA) në Lille që prej vitit 2015, si dhe bisedimet midis shtabeve respektive të dy vendeve.

Gjithashtu gjatë takimit gjeneralmajor, Prof.Asoc, Begaj pasi shprehu ngushëllimet për humbjet tragjike të jetëve të pafajshme nga sulmet terroriste të ditëve të fundit në Francë, e siguroi atë se FARSH solidarizohen dhe qëndrojnë krahas kolegëve të tyre francezë.

Në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit ranë në dakordësi për vijimin dhe rritjen e bashkëpunimit në fusha specifike me interes të përbashkët.



Gjeneralmajor, Prof.Asoc, Begaj shprehu ngushëllimet për humbjet tragjike të jetëve të pafajshme nga sulmet terroriste të ditëve të fundit në Francë dhe e siguroi kolonel Fabrice Duda se FARSH solidarizohen dhe qëndrojnë krahas kolegëve të tyre francezë.

Ambasada Amerikane në Tiranë



FA po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e lëndëve shpërthyesë

Organizata amerikane "Golden West" e specializuar në asgjësimin e lëndëve shpërthyesë trajnon ushtarakët shqiptarë

Ushtria shqiptare po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e sigurt të lëndëve shpërthyesë. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bëri të ditur me 27 tetor 2020 se, "Organizata Jofitimprurëse e Shteteve të Bashkuara "Golden West", e vetmja organizatë jofitimprurëse amerikane e specializuar në asgjësimin e lëndëve shpërthyesë dhe menaxhimin e rezervave të armëve, ofroi trajnim të rëndësishëm udhëheqjeje për Forcat e Armatosura Shqiptare javën e kaluar". Ambasada e SHBA thekson se, "ky trajnim u financua nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tregon se si ushtria shqiptare po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e sigurt të lëndëve shpërthyesë".

"Ky trajnim u financua nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tregon se si ushtria shqiptare po bëhet udhëheqëse në menaxhimin e sigurt të lëndëve shpërthyesë".

AMERIKANËT TESTOJNË BAZAT USHTARAKE TË SHQIPËRISË

Stërvitja ndërkombëtare "Defender Europe 2021"

Në këtë stërvitje do të marrin pjesë mbi 8.000 trupa amerikane, që do të dislokohen në disa rajone të vendit dhe në disa reparte të Forcave tona të Armatosura

Përrreth një javë oficerë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës Amerikane në Europë, zhvilluan vizita njohëse në bazat apo rajonet stërvitore të vendit, ku është parashikuar të zhvillohet stërvitja "Defender Europe 2021".

Stërvitja ndërkombëtare "Defender Europe 2021" pritet të zhvillohet pranverën e ardhshme dhe do shtrihet thuajse në të gjitha bazat tokësore, detare apo ajrore të Shqipërisë, nga

veriu në jug. Për këtë qëllim, grupi i punës i Forcave të Armatosura dhe përfaqësuesit ushtarakë amerikanë zhvilluan vizita njohëse në të gjitha këto baza ku është parashikuar të zhvillohet stërvitja.

Ushtarakët amerikanë u njohën me kapacitetet që logjistikën që ofrojnë Forcat e Armatosura, si dhe panë vetë në terren mundësitë që ofrojnë bazat ushtarake të Shqipërisë për mbarëvajtjen e kësaj stërvitjeje të pazakontë për nga përmasat në territorin tonë.

Stërvitja "Defender Europe 2021" u cilësua nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka si një nga stërvitjet më të mëdha, që është zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri.

Siç u shpreh ajo gjatë prezantimit të projektbuxhetit të Mbrojtjes për vitin 2021 në Komisionin e Sigurisë, kjo stërvitje "është e para e këtij lloji në vendin tonë dhe do të marrin pjesë mbi 8.000 trupa amerikane, që do të dislokohen në disa rajone të vendit dhe në disa reparte të Forcave tona të Armatosura."



Marrin pjesë forcat ushtarake britanike

Fillon stërvitja "Rural Surveillance and Patrol Training"

Në ambientet e Repartit 1050, Zall-Herr, Tiranë u zhvillua ditën e martë më 3 nëntor 2020, ceremonia e fillimit të stërvitjes "Rural Surveillance and Patrol Training". Në këtë ceremoni, mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti dhe përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore. Kjo stërvitje kryhet midis batalionit të Forcave Speciale Shqiptare dhe Batalionit të Dytë të Regjimentit të Dukës së Lankasterit (2LANCS) i Mbretërisë së Bashkuar. Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti komandanti i bF5, nënkolonel Ajet Jata, i cili theksoi se: "Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe ndërtimi i marrëdhënieve vëllazërore ndërmjet

"Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje është shkëmbimi i eksperiencave dhe ndërtimi i marrëdhënieve vëllazërore ndërmjet aleatëve të NATO për qëllimet tona të përbashkëta strategjike"

aleatëve të NATO për qëllimet tona të përbashkëta strategjike".

Shefi i Shtabit të Forcës Tokësore kolonel Ilirjan Dauti, në fjalën e tij përshëndetëse ndër të tjera u shpreh se: "Ne jetojmë në një botë të pa parashikueshme ku ne si aleatë pa dyshim mund të na ndodhë të operojmë së bashku atje ku do të ketë konflikt, prandaj kjo është arsyeja që të trajnohemi së bashku për t'iu përgjigjur çdo kërcënimi që mund të

ndodhë në të ardhmen."

Kjo stërvitje do të zgjasë tre javë dhe do të zhvillohet në ambientet e batalionit të Forcave Speciale dhe Poligonit Kombëtar të Bizës. Ndër temat kryesore që do të zhvillohen në këtë stërvitje do të jenë: planizim, zbulim special, armatim, xhenio, shendetsi, patrullim në këmbë dhe me mjete, rënie në kontakt me kundërshtarin, mbulimi dhe kamuflimi, zënia e pikës së vrojtimit, goditje objekti, etj.



SHËRBIMI HIDROGRAFIK I FORCËS DETARE

Rivendoset bova ndriçuese në Kepin e Rodonit

Specialistët e fenerëve të Shërbimit Hidrografik, të Forcës Detare, kanë Shërbë të mundur më 4 tetor 2020, rivendosjen e bovës ndriçuese (kardinale) në Kepin e Rodonit, vendosjen në gatishmëri të fenerit kufizues në kanal in e Portit të Durrësit si dhe vendosjen në gatishmëri të fenerit kufizues me ishullin e Sazanit. Ky shërbim rrit sigurinë lundimore në hapësirën detare dhe në portet e vendit tonë, si dhe garanton shërbimin 24/7, pasi rreth 80% e transportit të mallrave bëhet përmes rrugëve detare.



QENDRA E ARSIMIMIT PROFESIONAL TË NËNOFICERËVE

Certifikohen 56 kursantë në Kursin 67-të fillestar të nënoficerëve

Me datë 30.10.2020 në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 56 kursantëve të Kursit 67-të Fillestar të Nënoficerëve.

Kursi zgjati pesë javë dhe u zhvillua në ambientet e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve në Zall-Herr. "Ofrimi i njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuar me të, si dhe shpejtë nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues", ishte objektivi i kursit, i cili u realizua me sukses edhe pse në kushtet e zbatimit të masave anti-covid 19.

Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN, personeli mësimdhënës dhe kursant.

Fjalën e hapjes e mbajti Instruktori Përgjegjës i Kursit Fillestar në QAPN, rreshter Andi Ahmet ku ndër të tjera u shpreh: "Jam i kënaqur me punën e bërë nga gjithë personeli kursant, të cilët kanë dhënë maksimumin e mundshëm për realizimin me sukses të programit të kursit. Përfundimi i këtij kursi nga ana Juaj është një hap i rëndësishëm në kar-



rierën ushtarake të gjithësejçilit duke ju hapur rrugën e karrierës për t'ju bashkuar trupës së Nënoficerëve në të ardhmen".

Më tej fjalën e mori Ushtar IV Ornela Dëshiku e cila theksoi se: "Gjej rastin të falenderoj të gjithë mësimdhënësit dhe drejtuesit e QAPN-së, që na

ndihmuan pa hezitim për përvetësimin sa më të mirë të programit mësimor, si dhe përballimin e vështirësive të hasura gjatë kursit. Kishim dy fish an-

gazhim si në përvetësimin e programit mësimor dhe në zbatimin e masave anti covid-19 por ja dolëm me sukses. Në këtë kurs, ne përfituam shumë njohuri të cilat do të na shërbejnë në formimin tonë si komandantë të ardhshëm grupi".

Në përfundim të kësaj ceremonie fjalën e mbajti Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve kolonel Elton Bregu ku ndër të tjera theksoi: "Vlerësoj punën e bërë nga i gjithë personeli mësimdhënës dhe kursant, shpreh besimin se njohuritë që keni përfutuar në këtë kurs janë të mjaftueshme për përparimin në karrierën ushtarake të gjithësejçilit. Uroj të jeni më së miri në gjendje ti përdorni nëpër pozicionet dhe detyrat e ardhshme, ti zhvilloni më tej ato duke i pasuruar me procedurat dhe teknikat më të reja që përdoren nga vendet aleate. Përvetësimi i njohurive të marra në këtë kurs do të ndikojnë drejtëpërdrejtë në kultivimin e intelektit të kursantëve, si komandantë të ardhshëm grupi." Me shpërndarje e certifikatave të kursit për 56 kursantët u bë mbyllja e ceremonisë.

Ligji Nr.36/2020

"Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë"

Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE", të ndryshuar". Numri CELEX 32009L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 216, datë 20.8.2009, faqe 76-136



kryesor të kontratës, vlerësohen "kontrata për shërbime".

16. "Kontratë prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" është një kontratë me shpërbim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një ose më shumë ofertuesve dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që ka si objekt të prokurimit kryerjen e punëve, furnizimin e mallrave ose ofrimit të shërbimeve në përputhje me këtë ligj.

17. "Krizë" është një situatë e sigurisë në një zonë të caktuar e më gjerë, e cila nuk mund të kontrollohet me resurse dhe masa të zakonshme, në të cilën kërcënohen vlerat themelore të shoqërisë për shkaqe ushtarake, ekonomike, sociale dhe shkaqe të tjera, të cilat mund të kapërcejnë kufijtë shtetërorë. Konfliktet e armatosura dhe luftërat duhet të konsiderohen si kriza për qëllim të këtij ligji.

18. "Marrëveshje kuadër" është një marrëveshje, ndërmjet një ose më shumë autoriteteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, atje ku është e përshtatshme, me sasi të parashikuara.

19. "Mënyrë elektronike" është përdorimi i pajisjeve elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin digjital), që transmetohen, jepen e merren nëpërmjet kabllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik.

20. "Nënkontratë" është kontrata me shkrim, e lidhur për interes financiar, nëpërmjet ofertuesit fitues dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë për të zbatuar kontratën, që ka objekt të saj punime, furnizim me mallra apo kryerjen e shërbimeve.

21. "Ofertues" është operatori ekonomik që paraqet një ofertë në një procedurë të kufizuar ose me negociim ose në një dialog konkurrues.

22. "Operator ekonomik" është një kontraktor, furnizues ose ofrues i shërbimeve.

23. "Pajisje ushtarake" janë pajisjet e projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale për

për pjesëmarrje, në vijim të së cilës autoriteti kontraktor komunikon me kandidatët e përzgjedhur prej tij me qëllim paraqitjen e një ose më shumë alternativave, të cilat plotësojnë kërkesat e tij. Bazuar në alternativat që ofrohen, kandidatët e përzgjedhur ftohen të paraqesin ofertë.

7. "Dokumentet e tenderit" janë dokumentet, që autoriteti kontraktor u vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave.

8. "Informacion i klasifikuar" është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma dhe natyra ose mënyra e transmetimit e tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur niveli i caktuar i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit në pajtim me legjislacionin në fuqi, në interes të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, që kërkon mbrojtje nga çdo lloj shkatërrimi, humbje, vjedhje, rrjedhje, përhapje të paautorizuar ose aksesit nga çdo individ i paautorizuar ose çdo lloj tjetër komprometimi sigurie, ku përfshihet: informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror", i NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar një marrëveshje sigurie.

9. "Kandidat" është operatori ekonomik, që kërkon të ftohet në një procedurë të kufizuar ose me negociim ose me një dialog konkurrues.

10. "Kërkimi dhe zhvillimi" nënkupton të gjitha aktivitetet që përfshijnë kërkimin bazë, kërkimin e aplikuar dhe zhvillimin eksperimental, ku i ky i fundit mund të përfshijë realizimin e demonstrimeve teknologjike, si pajisjet që tregojnë performancën e një koncepti të ri ose të një teknologjie të re, në një mjedis përkatës ose përfaqësues.

11. "Komunikim me shkrim" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë dhe/ose shifra, që mund të lexohen, kopjohen dhe më pas të komunikohen, duke përfshirë edhe informacionin që transmetohet apo ruhen me mjete elektronike.

12. "Kontraktor", "Furnizues", "Ofrues i shërbimit" është çdo person fizik, juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg sipërmarrjen e një ose disa punëve, furnizim me mallra ose shërbime.

13. "Kontrata e punëve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" është kontrata që ka për objekt projektimin dhe realizimin e punëve apo realizimin, me çfarëdo mjeti, të një pune që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

14. "Kontrata e furnizimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" janë kontratat e ndryshme nga kontrata e punëve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë, me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë rastësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si "kontratë furnizimi", nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo të instalimit.

15. "Kontrata shërbimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë" janë kontratat, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Një kontratë, që ka objekt furnizimin me mallra dhe shërbime, vlerësohet si "kontratë për shërbime", nëse vlera e këtyre të fundit tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë. Kontratat, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Ky ligj ka si objekt të tij kontratat që lidhen në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë për:

a) furnizimin me pajisje ushtarake dhe pjesët dhe/ose njësitë përbërëse të tyre;

b) furnizimin me pajisje të klasifikuara dhe pjesët dhe/ose njësitë përbërëse të tyre;

c) punë, mallra dhe shërbime që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", për çdo dhe të gjitha elementet e ciklit jetësor të tyre;

ç) punë, pajisje dhe shërbime ushtarake që, për arsye sigurie, përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar dhe trajtohen si punë, mallra dhe shërbime të klasifikuara.

2. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë së institucioneve shtetërore dhe të mbrojtjes dhe sigurisë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 3

Parimet e prokurimit

Autoritetet kontraktore veprojnë në mënyrë transparente dhe i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, duke respektuar parimet e mëposhtme:

a) rritjen e efikasitetit dhe të efikasitetit në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;

b) sigurimin e mirë përdorimit të fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale;

c) nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e këtyre prokurimeve;

ç) nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura;

dh) sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet kontraktor" është një institucion shtetëror, që kryen procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2. "Certifikata e Sigurimit Industrial (CSI)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një operator ekonomik ka kapacitetet dhe aftësitë organizative, teknike e fizike dhe i plotëson standardet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar në një projekt/program apo kontratë/nënkontratë të klasifikuar.

3. "Certifikata e Sigurimit të Personelit (CSP)" është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurimin e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton, nga pikëpamja e sigurisë, se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

4. "Cikli jetësor" janë të gjitha fazat e mundshme të njëpasnjëshme të një produkti, si kërkimi dhe zhvillimi, zhvillimi industrial, prodhimi, riparimi, modernizimi, modifikimi, mirëmbajtja, logjistika, trajnimi, testimi, tërheqja nga tregu dhe asgjësimi.

5. "Çmimi i kontratës" është çmimi që i paguhet kontraktuesit/furnizuesit sipas kontratës, për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktuale.

6. "Dialog konkurrues" është procedurë prokurimi me faza, në të cilën çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë

Neni 5

Përfshirje të veçanta

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:

a) prokurimet, për të cilat zbatimi i dispozitave të këtij ligji do ta detyronte shtetin të zbulonte informacione, bërja publike e të cilave është në kundërshtim me interesat e tij në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë;

b) të gjitha prokurimet e punëve, mallrave dhe shërbimeve në funksion të formave dhe metodave të veprimtarisë informativo-operative, të miratuara me ligj;

c) prokurimet e bëra në kuadër të një programi bashkëpunimi ndërshtetëror, të kryer me qëllim zhvillimin e një produkti të ri dhe, sipas rastit, edhe në fazat e mëvonshme, gjatë ciklit jetësor ose të një pjese të ciklit jetësor të këtij produkti;

ç) prokurimet e bëra në një vend të tretë, duke përfshirë prokurimet civile, të kryera kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit, kur për nevoja operationale duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë që janë në vendin ku po kryhet operacioni;

d) kontratat e shërbimit për blerjen, marrjen me qira, me çdo mjet financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese ose të pasurive të tjera të paluajtshme apo të të drejtave mbi to;

dh) kontratat që lidhen ndërmjet dy qeverive për: i. furnizimin me pajisje ushtarake ose pajisje të klasifikuara; ii. punë dhe shërbime, që lidhen drejtpërdrejt me këto pajisje; iii. punë dhe shërbime të posaçme për qëllime ushtarake, ose punë dhe shërbime, që, për arsye sigurie përfshijnë, kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar.

e) shërbimet e arbitrazhit dhe pajtimit; ë) shërbimet financiare, me përjashtim të shërbimeve të sigurimit të mallit;

f) kontratat e punësimit;

g) shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit, rezultatet e të cilave shfrytëzohen nga të gjithë, përveç rasteve kur përfitimet i shkojnë vetëm Autoritetit Kontraktor, për përdorimin prej tij për 5 nevojat e brendshme dhe me kusht që shërbimi i kryer të paguhet plotësisht nga ky autoritet kontraktor;

gj) prokurimet, në rastet kur autoritetet kontraktore kanë marrëveshje dhe/ose realizojnë prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë nëpërmjet agjencive të NATO-s, organizmave ndërkombëtarë, ku Shqipëria aderon, me fondet dhe për interes të autoriteteve kontraktore;

h) të gjitha prokurimet e punëve, mallrave dhe shërbimeve në rastet e krizave dhe/ose situatave ekstreme të sigurisë kombëtare;

“Automjetet do të sigurojnë manovrim, aftësi mbrojtëse, por edhe një forcë zjarri krejtësisht të ndryshme të njësive tona të këmbësorisë, e cila do t’u mundësojë njësive tona të stërviten dhe më vonë të marrin pjesë në misione me partnerët tanë, por me burimet e tyre, pa pasur nevojë të përdorin logjistikën e partnerëve. Kjo është diçka për të cilën kemi punuar me përkushtim dhe intensivisht”.



Vendi i parë evropian që do të përdori makina të blinduara “Oshkosh”

Ushtria do pajiset me 67 mjete “Oshkosh” me vlerë 35 milionë USD

Mali i Zi dhe SHBA-ja nënshkruan një marrëveshje për automjetet e blinduara në tetor të vitit të kaluar me vlerë 36.165.105 dollarë

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bošković, mori pjesë më 30 tetor 2020, në prezantimin e automjeteve të reja të blinduara të lehta “Oshkosh” me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Malin e Zi, Judy Rising Reinke dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, Gjeneral Major Dragutin Dakić.

Pas kësaj dite, absolutisht asgjë nuk do të jetë e njëjtë për Ushtrinë e Malit të Zi. “Ceremonia e sotme është një tregues i asaj që mund të bëjmë së bashku me partnerët tanë në një kohë të shkurtër, në një mënyrë transparente, efikase dhe më të mirë për interesat e shtetit, dmth Ushtrisë së Malit të Zi,” tha Bosković, duke falënderuar kështu partnerët amerikanë.

Pesë automjete “Oshkosh” mbërritën në Malin e Zi, javën që kaloi dhe këto ditë do mbërrijnë 15 të tjera, kurse dhe deri në 2023 do plotësohet tërë kontrata për 67 automjete të blinduara. Këto automjete do të pajisin dy struktura të këmbësorisë të deklaruara të Ushtrisë së Malit të Zi, një përparësi e nivelit më të lartë sipas Planit të Zhvillimit të Mbrojtjes të Malit të Zi për periudhën nga 2019 deri në 2028.

“Automjetet do të sigurojnë manovrim, aftësi mbrojtëse, por edhe një forcë zjarri krejtësisht të ndryshme të njësive tona të këmbësorisë, e cila do t’u mundësojë njësive tona të stërviten, stërviten, dhe më vonë të marrin pjesë në misione me partnerët tanë, por me burimet e tyre, pa pasur nevojë të përdorin logjistikën e partnerëve. Kjo është diçka për të cilën kemi punuar me përkushtim dhe intensivisht,” vuri në dukje Ministri Boskovic. Në prezantimin në kazemat “Milovan



Sharanovic” në Danilovgrad, Ministri gjithashtu falënderoi ekipin e tij. “Unë jam i lumtur që pas katër vitesh në Ministrinë e Mbrojtjes, ne kemi krijuar një ushtri që është më e aftë dhe më e shkathët, dhe mbi të gjitha një ushtri që është e gatshme ta vërë veten në shërbim të çdo qytetari të Malit të Zi në periudhën e mëpasshme”,- përfundoi ministri

Bošković. Ambasadorja e SHBA në Malin e Zi, Judy Rising Reinke, gjithashtu shprehu mirënjohjen e saj për bashkëpunimin, duke thënë se Mali i Zi hapi rrugën me blerjen e automjeteve dhe u bë vendi i parë evropian që përdori makina të lehta taktike të blinduara “Oshkosh”. “Mali i Zi është i pari nga të gjithë aleatët evropianë

të NATO-s që prokuron automjetet e lehta të blinduara ushtarake më të përparuara në botë. Në muajt e ardhshëm, aleatë të tillë si Sllovenia, Belgjika, Lituania dhe Mbretëria e Bashkuar do të bashkohen me Malin e Zi dhe do të sigurojnë këto automjete të blinduara, të cilat do t’u mundësojnë vendeve të përmendura të bashkëpunojnë me njëri-

tjetrin gjatë stërvitjeve shumëkombëshe dhe misioneve të përbashkëta brenda operacioneve të NATO-s”,- tha ajo. Ajo shtoi se automjetet përfaqësojnë një investim shumë të rëndësishëm në aftësitë e ushtrisë malazeze dhe tregojnë një arritje të rëndësishme në rrugën e përpjekjeve të vazhdueshme për ta modernizuar atë.

“Shtetet e Bashkuara kanë privilegjin të jenë në gjendje të llogarisin Malin e Zi si një mik, partner dhe aleat. Ne jemi gjithmonë me njerëzit e Malit të Zi, si në këto mundësi të bukura, ashtu edhe në kohë të vështira, siç është kriza aktuale shëndetësore. “Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë pa mëdyshje t’i sigurojnë mbështetje Malit të Zi në rrugën e tij drejt Perëndimit, anëtarësia e së cilës në NATO është përbërësi kryesor,”- përfundoi ambasadori. Mali i Zi dhe Shtetet e Bashkuara nënshkruan një marrëveshje mbi prokurimin e automjeteve të blinduara në tetor të vitit të kaluar. Vlera e kontratës është 36.165.105 dollarë.

MINISTRI PREDRAG BOŠKOVIĆ-AMBASADORI GREGOR PRESKER

Mali i Zi-Slloveni: Bashkëpunim dypalësh në fushën e mbrojtjes

Mali i Zi dhe Republika e Sllovenisë janë të përkushtuara për të vazhduar aktivitetet në drejtim të forcimit të mbrojtjes dhe krijimit të stabilitetit

Ministri i Mbrojtjes, Predrag Bošković, u takua me Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë, Gregor Presker, dhe të Dërguarin e Mbrojtjes së atij vendi në Mal të Zi, Kapitenin e anijes luftarake “Boris Geršak”. Në takim, ministri vuri në dukje se Republika e Sllovenisë është një nga vendet kryesore aleate të Malit të Zi, mbështetja dhe ndihma e të cilit kanë një rëndësi të pamatshme për zhvillimin dhe përparimin e ushtrisë malazeze.

Ministri Boshkovic vuri në dukje cilësinë dhe përmbajtjen e bashkëpunimit midis dy vendeve, i cili mund të shërbejë si një shembull i shkëlqyeshëm i mbështetjes së ndërsjellë dhe besimit të fortë. Kjo është arsyeja pse ministri theksoi nevojën për të forcuar më tej bash-

këpunimin rajonal të mbrojtjes përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativat rajonale. Bosković theksoi gjithashtu se një përgjigje efektive ndaj sfidave të sigurisë kërkon përmirësimin e kapaciteteve të duhura institucionale dhe se Mali i Zi punon me zell në nivelin kombëtar dhe në bashkëpunim me aleatët për të mbrojtur interesat kombëtare.

Ministri shprehu mirënjohje të veçantë për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë për bashkëpunimin e ushtrive të të dy vendeve në kuadër të Grupit Shumëkombësh në Letoni si një kontribut për praninë e forcuar në Lindje (EFP), duke shtuar se ky lloj bashkëpunimi është i një rëndësie të pamatshme për Malin e Zi. Ambasadori Presker tha se pasi fitoi anëtarësimin e plotë në Aleancë,

Mali i Zi, në një periudhë relativisht të shkurtër, përmirësoi ndjeshëm aftësitë e tij mbrojtëse dhe kështu konfirmoi statusin e tij si një aleat i përgjegjshëm dhe i besueshëm. Gjatë bisedimeve, ai tha se pret, që Republika e Sllovenisë dhe Mali i Zi do të vazhdojnë të zhvillojnë bashkëpunimin dypalësh të mbrojtjes në periudhën e ardhshme, të cilën ai e sheh si përfitim të dyfishta në formën e forcimit të sistemeve të mbrojtjes kombëtare dhe kontributin në sistemin e sigurisë kolektive.


Bashkëbiseduesit shprehën kënaqësinë për aspiratat e larta të të dy palëve për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe konfirmuan gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet, si dypalëshe dhe multilaterale.

Operacioni detar “Eu Navfor- Atalanta”

Ekipi i ushtrisë së Malit të Zi në operacionin e Bashkimit Evropian

Dymbëdhjetë anëtarë të Ekipit IV të Marinës të Malit të Zi u dërguan në operacionin detar të Bashkimit Evropian “Eu Navfor- Atalanta”

Anëtarët e kontigjentit IV AVPD kaluan një proces trajnimi dhe përgatitje disa mujor në anijet e Marinës Malazeze. Përgatitjet janë ndërlikuar më tej në muajt e fundit për shkak të zbatimit të masave epidemiologjike kundër COVID-19. Në fund të procesit, anëtarët e ekipit treguan vullnet të lartë dhe gatishmëri për të përfunduar detyrën. Para se të nisej për operacionin, komandanti i Marinës, kapiteni i fregatës Goran Đurković, i falënderoi ata dhe i uroi suksese gjatë ekzekutimit të kësaj detyre shumë komplekse. Komandanti i ekipit AVPD, toger i fregatës Lazar Knežić, falënderoi në emër të ekipit për besimin dhe mbështetjen. Ekipet AVPD janë njësi të pavarura që janë të angazhuara në operacionin detar të Bashkimit Evropian “Eu Navfor Atalanta”. Përveç Malit të Zi, Serbia, Kroacia dhe Lituania kontribuojnë në operacion me ekipe AVPD. Qëllimi kryesor i ekipeve AVPD është të mbrojnë anijen tregtare që dërgojnë ndihma humanitare nga Programi Botëror i Ushqimit (WFP) popullit të Somalisë. Detyra e ekipit është të parandalojë, sigurojë, mbrojë anijen dhe ngarkesën nga sulmet e mundshme pirate, rrëmbimet, ose grabitjet. Anëtarët e Ushtrisë së Malit të Zi kanë marrë pjesë në operacionin “Eu Navfor Atalanta” që nga viti 2010 dhe kanë kryer detyrat e tyre në Komandën e Operacionit, si dhe në anijet në zonën e operacionit.



Në stërvitjen “Poseidon-2020” përveç anijeve luftarake Bullgare dhe Rumune morën pjesë anije nga marina e Greqisë, Turqisë, Italisë, Spanjës dhe Francës. Ata janë pjesë e Grupit të Dytë të Përhershëm të Minave të NATO-s në Mesdhe (SNMCMG2). Selia për kontrollin e stërvitjes ishte vendosur në Stacionin Bazë në Burgas.



BASHKËPUNIMI DETAR USHTARAK MIDIS SHTETEVE

Zhvillohet stërvitja Bullgare-Rumune “Poseidon-2020”

Në stërvitjen “Poseidon-2020” përveç anijeve luftarake bullgare dhe rumune morën pjesë anije nga Greqia, Turqia, Italia, Spanja dhe Franca

Një flotilje e anijeve luftarake dhe anijeve mbështetëse të Marinës Bullgare kanë zhvilluar stërvitjen për veprimin kundër minave detare. Stërvitja ishte dypalëshe bullgare-rumune e quajtur “Poseidon-2020”. Kjo stërvitje është mbajtur nga data 30 tetor deri më datën 6 nëntor 2020 në detin territorial dhe zonën ngjitur me Republikën e Bullgarisë. Qëllimi i stërvitjes “Poseidon-2020” ishte që të përmirësohej niveli i trajnimit të personelit të Marinës për kryerjen e veprimit ndaj minave detare në një format koalicioni dy palësh bullgar-rumun. Stërvitja ishte planifikuar, organizuar dhe udhëhequr sipas standardeve dhe procedurave të NATO-s.

Në stërvitjen “Poseidon-2020” përveç anijeve luftarake Bullgare dhe Rumune morën pjesë anije nga marina e Greqisë, Turqisë, Italisë, Spanjës dhe Francës. Ata janë pjesë e Grupit të Dytë të Përhershëm të Minave të NATO-s në Mesdhe (SNMCMG2). Selia për kontrollin e stërvitjes ishte vendosur në Stacionin Bazë në Burgas.

Stërvitja anti minë detare, quajtur “Poseidon-2020” është mbajtur çdo vit që nga viti 2002. Pritës mbi një bazë rrotacioni janë gjithnjë marinat luftarake të Bullgarisë dhe Rumanisë.



Ministri Karakachanov: “Një komb që nuk mendon, nuk ka të ardhme”

Ministri i Mbrojtjes Krasimir Karakachanov, në aktivitetin e organizuar në Ministrinë e Mbrojtjes shpërbleu me çmime figura të shquara publike me rastin e 1 Nëntorit si “Dita e Rilindjes bullgare”. Çmimet jepen për merita të dëshmuara në fushën e shkencës dhe kulturës, profesionalizëm të lartë, kontribut në Ministrinë e Mbrojtjes, etj. Kështu ministri i Mbrojtjes Krasimir Karakachanov, ka dhënë çmime për Major Ventsislav Mutafchiiski-Shefi i Akademisë Mjekësore Ushtarake, Kryemjekun e Forcave të Armatosura Ivan Stambolov, publicist dhe shkrimtar Dimitar Dimitrov, gazetarin dhe drejtuesin e programit politik rishikues “Panorama” në BNT Bojko Vasilev, botuesin dhe themeluesin e shtëpisë botuese “BARD” Yordan Antov; Galina Zlatareva-shkrimtare, etj. “Secili prej jush e ka bërë Bullgarinë të zgjohet me diçka për të menduar. Një komb që nuk mendon, nuk ka të ardhme,”- tha Ministri Karakachanov në fjalën e tij. Ai theksoi se tradicionalisht në



prag të 1 nëntorit, Ministria e Mbrojtjes shpërbleu jo vetëm njerëzit e lidhur me ushtrinë, por edhe shkencëtarët dhe figurat publike që kanë merita për zgjimin e kombit Bullgar. “Ringjallja ka të bëjë me ushtrinë, sepse ata ushtarë bullgarë për të cilët ne nderojmë dhe jemi krenarë nuk kanë humbur një betejë pikërisht, sepse ata kanë qenë mjaft të ndriçuar, mjaft të vetëdijshëm si bullgarë. Sot, si ushtria, ashtu edhe e gjithë shoqëria bullgare kanë nevojë për ringjalljen e saj të re,”- tha ministri

Karakachanov. Ai falënderoi fituesit, i uroi suksese dhe shprehu shpresën se Iluministët në Bullgari do të bëhen gjithnjë e më shumë. “Ne jemi të kënaqur që ekziston një institucion i tillë si Ministria e Mbrojtjes, e cila çdo vit i kushton vëmendje dhe shpërblen bullgarët që sot bëjnë diçka në emër të Bullgarisë. Jam i bindur që ne do të vazhdojmë të bëjmë gjëra të dobishme për Bullgarinë në të njëjtën mënyrë,”- tha Galina Zlatareva në emër të të gjithë fituesve.

Tetëdhjetë e tre oficerë diplomohen nga Akademia Ushtarake

Tetëdhjetë e tre oficerë nga Akademia Ushtarake morën me 30 tetor, diplomat për arsimin e lartë të përfunduar diplomë master, në specialitetin Organizimi dhe menaxhimi i formacioneve ushtarake në nivelin operativ. Shefi i Mbrojtjes, Admiral Emil Eftimov, mori pjesë në aktin solemn për dhënien e diplomave.

“Ju keni një shans të diplomoheni në kohë historike për Ushtrinë Bullgare dhe Forcat e Armatosura. Procesi i modernizimit të Forcave të Armatosura që ka filluar është i pakthyeshëm, i domosdoshëm dhe i garantuar nga udhëheqja e shtetit. Procesi është i gjatë dhe i vështirë, ne kemi për detyrë ta kthejmë burimin e shtrenjtë të alokuar të shtetit në aftësi reale mbrojtëse,”- tha në fjalimin e tij drejtuar të diplomuarve Admiral Emil Eftimov. “Ju, oficerët që tani jeni duke diplomuar në Alma Mater-in tonë ushtarak, do të vini në veprim Planin e Zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe Planin-Programin e Investimeve. Ju do t’i demonstroi shtetit dhe shoqërisë organizatën e re të Forcave të Armatosura dhe aftësitë e reja. Detyra para jush është të përdorni përpjekjet e brezave të oficerëve. Jam i bindur që ju do ta përmbushni këtë përgjegjësi,”- ishte kategorik Shefi i Mbrojtjes. Ai vuri në dukje kushtet e pazakonta të vendosura nga masat anti-epidemike në të cilat oficerët përfundojnë trajnimin e tyre.

“Sfidat ishin për komandën dhe mësuesit e Akademisë Ushtarake, por mbi të gjitha për ju për të shfrytëzuar në maksimum kohën e trajnimit, për t’i dhënë kuptim materialit dhe nivelit që po studioni për të përfunduar kursin me një vështrim të ri në shërbim, marrëdhëniet në Forcat e Armatosura, puna e stafit, planifikimi dhe zhvillimi i stërvitjeve, burimet dhe mjedisi i komunikimit dhe informacionit, i cili është i një rëndësie kritike për tre llojet e Forcave të Armatosura,”-tha Admirali Emil Eftimov. Ai uroi që maturanët të mbanin pikëpamjen e tyre kritike në shërbimin e tyre të ardhshëm në Forcat e Armatosura.

Gjeneralmajori Grudi Angelov, kreu i Akademisë Ushtarake, uroi shëndet, prosperitet dhe ëndrra të bëhen realitet në fjalimin e tij drejtuar të diplomuarve. “Sot ju merrni mirënjohje për përpjekjet që keni bërë gjatë trajnimit tuaj në Akademinë Ushtarake dhe përmirësimin e aftësive tuaja për marrjen e vendimeve të drejta të drejta. Akademia ushtarake ju ka dhënë udhëzime, por varet nga ju që të arrini suksesin tuaj në të ardhmen. Diploma nuk është vetëm një shprehje e njohurive dhe përvojave të fituara dhe kompetencave të reja, por edhe një përgjegjësi e madhe. Mos harroni se nuk është e mjaftueshme vetëm për të studiuar dhe përgatitur, ju duhet të jeni në gjendje të merrni përgjegjësi, të jeni një udhëheqës dhe model në punë dhe në jetë. Kjo është e nevojshme për ushtrinë dhe shoqërinë sot,”- tha ai.



Instituti i Makinerisë dhe Industrisë Kimike (MKEK)

Turqia teston armën e re kundërajrore të kalibrit 25 mm

Arma përdoret në automjete të blinduara dhe në platforma armësh të telekomanduara do të shërbejë si arma kryesore në të gjitha kushtet e motit dhe mjediset luftarake

Forcat e Armatosura Turke po përgatitet të shtojë në inventarin e saj sistemin me armë të mbrojtjes kundërajrore të kalibrit 25 milimetra, i cili është prodhuar plotësisht me mundësi vendore dhe kombëtare dhe që kaloi me sukses testet e qitjes.

Instituti i Makinerisë dhe Industrisë Kimike (MKEK), i lidhur me Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare, i cili intensifikon prodhimin e armëve dhe municioneve bashkëkohore paralelisht me studimet e kërkimit dhe zhvillimit, i është afruar fundit në prodhimin e një sistemi të ri të armëve.

Një armë kundërajrore e kalibrit 25 milimetra u prodhua brenda fushës së përpjekjeve për të përmirësuar efektivitetin dhe lëvizshmërinë e strategjive ushtarake duke rritur aftësitë luftarake të Forcave të Armatosura të Turqisë.

Arma kundërajrore, e prodhuar tërësisht me mundësi vendore dhe kombëtare, mund të bëjë qitje me një plumb, me tre, dhjetë dhe qitje serike. Arma që mund të përdoret në automjete të blinduara dhe në platforma armësh të telekomanduara do të jetë në gjendje të shërbejë si arma kryesore në të gjitha kushtet e motit dhe mjediset luftarake.

Sistemi i armëve 25 mm, i aftë për të qëlluar në mënyrë efektive shumë objektiva të ndryshëm, përfundoi para një muaji me sukses testet e qitjes në Drejtorinë e Fabrikës së Armëve të Institutit të Makinerisë dhe Industrisë Kimike në Çankiri.



Industria e Motorëve TAI fuqizon dronët "Akinci" dhe "TB3"

Selçuk Bayraktar, president i Bordit të Administruesve të Fondacionit të Skuadrës Teknologjike të Turqisë (Fondacioni T3) dhe drejtor teknik i kompanisë "Baykar", postoi në rrjetin social "Twitter" një video mbi motorin avionik prodhim vendës, të zhvilluar nga Industria e Motorëve të TAI-t (TEI).

"Motori avionik i zhvilluar nga TEI, projektuar kombëtarisht dhe prodhim vendës. Është motori avionik me performancën më të lartë në botë, me shumë distancë nga të ngjashmit e kësaj kategorie. Quajeni si të doni; e testuam dhe krahasuam... Ai do të fuqizojë (dronët) «Akinci» dhe «Bayraktar TB3», shkroi ai në "Twitter".

Bayraktar sqaroi se imazhet e testit janë të një muaji më parë dhe theksoi se motori i testuar nuk është më një prototip, por një motor i prodhimit në seri. Kanada njoftoi në fillim të këtij muaji pezullimin e lejeve të eksportit të armëve në Turqi lidhur me akuzat se ajo po përdor teknologjinë kanadeze në konfliktin ushtarak ndërmjet Armenisë dhe Azerbajxhanit në Karabakun Malor, territor azerbajxhanas nën pushtimin armen. Pas lëvizjes së Kanadasë, Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes së Turqisë (SSB) njoftoi se industria turke e mbrojtjes po vazhdon në rrugën e saj pavarësisht embargos.

Pilotja e parë e Turqisë është Bedriye Tahir Gokmen

Bedriye Tahir, që filloi arsimin e aviacionit në shkollën "Vecihi Uçus" në vitin 1932, nga njëra anë punonte si nëpunëse, nga ana tjetër vazhdonte edhe mësimet për aviatore. Për shkak të pasionit për fluturimin ajo u përball me shumë reagime dhe u ndesh me shumë pengesa, por ajo nuk hoqi dorë nga ëndrra e saj për të fluturuar. Abdurrahman Turk-

kusu, parashutisti i parë i Turqisë dhe drejtori i shkollës së parashutizmit, Bedriye Tahires, e cila duke u specializuar mori certifikatën e fluturimit në vitin 1933, i vuri pseudonimin "Gokmen". Me ligjin për mbiemrin ajo mori këtë mbiemër dhe u quajt Bedriye Tahir Gokmen. Në vitin 1934 ajo bëri kërkesë në Nënsekretaren e Forcave Ajrore për të konfirmuar licencën e saj dhe për miratimin e

certifikatave u kërkua që nxënësit të kalojnë nga një provim me avion. Por për shkak se kur erdhi komisioni për provimin, avioni i vetëm aktiv i shkollës ishte me defekt, provimi nuk u realizua dhe pas një kohe të shkurtër shkolla u mbyll. Pavarësisht se certifikata e saj nuk u miratua, Bedriye Tahir Gokmen zuri vend në historinë e aviacionit si pilotja e parë turke në qiell.



Kapsula Soyuz MS-16 kthehet në Tokë pas 6 muajve

Kapsula Soyuz MS-16, e cila ka qëndruar për 6 muaj në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës, në fund të muajit tetor 2020, u kthye në Tokë. Momenti i uljes së kapsulës Soyuz MS-16 u transmetua drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë Federale Ruse të Hapësirës (ROSCOSMOS). Kapsula që mbante kozmonautët rusë Anatoly Ivanishin dhe Ivan Vagner dhe astronautin e Agjencisë së Aviacionit dhe Hapësirës së Shteteve të Bashkuara (NASA) Christopher Cassidy u ul pranë qytetit kazak të Jezkazgan në 08.54 të mëngjesit me kohën lokale. Është vërejtur se ekipet e kërkim-shpëtimit, të cilët morën anëtarët e ekipit nga kapsula dhe kryen kontrolle shëndetësore, mbanin maska dhe ruanin distancën sociale. Në deklaratën e bërë nga ROSCOSMOS thuhet se numri i anëtarëve të ekipit të kërkim-shpëtimit që siguruan uljen e kapsulës u zvogëlua dhe testet e virusit dhe infeksionit u aplikuan për këta njerëz. Në deklaratë, gjithashtu bëhet e ditur se të gjitha pajisjet tokësore dhe të aviacionit të përdorura janë dezinfektuar.



Droni "Aksungur" kryen sulme ditën dhe natën

Në gjendje të mbajë deri në 750 kg ngarkesë, droni i armatosur «Aksungur», i projektuar dhe prodhuar nga kompania turke TUSAŞ, mund të kryejë misione inteligjence, vëzhgimi, zbulimi dhe sulmi në të gjitha kushtet e motit ditën dhe natën. Gjatë këtij fluturimi provë, droni turk fluturoi për 28 orë me 12 municione tip «MAM-L» të prodhuara nga kompania turke «Roketsan».



PROF.AS. DR. GENC LUARASI

Në Rekën e Epërme, në gjurmët e patriotit Josif Bagerit

Shumë patriotë janë përpjekur me të dhëna të tërthorta të përcaktojnë vitin e lindjes, të vdekjes si dhe vendin ku ka vdekur atdhetari shquar Josif Bageri. Sipas disave, rezultoi se ai ka lindur në vitin 1868, ndërsa për vdekjen, e veja e tij, Vasilika, ka dhënë datën 15 prill të vitit 1916, të cilën ia ka transmetuar djalit të saj të fundit, Aleksandër Josif Jovan Bageri. Jetën Josifi e filloi në fshat, duke ruajtur bagëtitë dhe herë-herë zbriste në Dibër, ku gjyshi i tij punonte nallban. Në këto lëvizje poshtë e lartë, duke u rritur djaloshi i ri me zgjuarsin mendon për të ardhmen. Kështu një ditë zbriti për të kërkuar punë në Dibër. E nisi si shegert këpucar, më pas shkoi në Tetovë dhe Gostivar në profesionin e këpucarit që e shoqëroi tërë jetën. Në këtë kohë në përpjekje për një jetë normale, ai njihet në moshën 16-17 vjeç me shoqen e ardhshme të jetës Vasilikën nga Prilepi, e cila iu bë krah i fortë në të mirë dhe vështirësi, duke i falur radhazi 9 fëmijë, shumë prej të cilëve nuk e jetuan jetën e tyre me ato kushte të vështira ekonomike, por këto nuk e përkulën çiftin për t'u bërë ballë vështirësive. Ata morën rrugën e kurbetit, me stacion të parë Bullgarinë dhe pikërisht në Sofje, e cila po mblidhte forca krahu, pasi në atë periudhë ishte shpallur autonome. Në Sofje ishte edhe një mase e madhe shqiptarësh nga viset e jugut të Shqipërisë, Korça, Kolonja, Përmeti, Gjirokastra, Elbasani, por ndër ta kishte edhe shumë dibrane dhe krutanë.

E solli fati që të vendosej me këta shqiptarë në kafenenë "Albania" dhe dyqanin ushqimor të patriotit boboshtar, Dhimitër Nikolla Mole. Atje çdo natë mblidheshin dhe shkëmbehin hallet e jetës së tyre zanatçinj, punëtorë ndërtimi etj. Në vitin 1895, vijnë në Sofje Koste Jani Trebicka dhe Kristo Papastefan Luarasi, të cilët bashkë me Dhimitër Molen filluan t'u mësojnë të rinjve shqip dhe t'u japin atyre libra.

Shpejt, shqiptarët organizohen në shoqërinë arsimore dhe kulturore me emrin simbolik "Dëshira", ku Josifi i ri filloi të spikaste jo vetëm si aktivist e veprimtar, por edhe si krijues me vjershat e tij. Në këtë kohë ai filloi t'u afrohet socialistëve bullgarë, duke mbrojtur dhe përfaqësuar shtresën e zanatçinjve, si këpucar, gurgdhendës, muratorë, të cilët, duke qenë se ruanin zanatin dhe veglat e tyre për mbijetese, kishin krijuar një organizatë të quajtur Mason, e cila kishte adoptuar edhe statutin e saj dhe karakterizohej nga një hije sekretit dhe fshehtësie profesionale. Kalimi me masonët solli një qëndrim largues nga shoqëria "Dëshira" të Josifit, ai tentoi të krijonte një shoqëri të re, "Bashkimi".

Në fund të vitit 1899, Josifi shkon për një vizitë në Stamboll që të njihet me vjershëtorin tonë të madh, Naim Frashëri, ku biseda me të i dha shtysë veprimtarisë së tij të mëtejshme, por vdekja e mikut të ri në vitin 1900 e vrau shumë. Vetë ai e përshkruan takimin me të madhin Naim Frashëri në Stamboll: "Në vitin 1898 më 12 të vjeshtës parë, patëm fatin e mirë të ndeshemi me shpirtndriturin e pa harruar kurrë, Naim Bej Frashërin, cili n'at kohë ishte shumë i sëmun, po na priti si fëmijë e



vet dhe u muerrëm vesh fort shumë mirë tuj u marr vetëm për çështjen kombëtare d.m.th. kuvendi ynë ishte vetëm për çështje kombëtare. Kuvendimi me këtë korife ishte i gjatë pavarësisht gjendjes së tij të rënduar shëndetësore".

Pas vdekjes së Naim Frashërit, largohet nga shoqëria dhe udhëton në Serbi dhe Kosovë. Duke udhëtuar në Pejë, shpreh idenë e bashkimit të dy trevave shqiptare, si dhe hapjen e shkollave shqipe si shprehje më e lartë e shqiptarizmit kundër Turqisë. Gjatë vizitës në Kosovë ai shpërndan gazetën "Drita" të Shahin Kolonjës dhe Kristo Luarasit.

Atje takohet me Bajram Currin.

Një shtytje për bashkim luftarak ishte njohja në Sofje me Çerçiz dhe Bajo Topullin, Mihal Gramenon, të cilët, pasi bënë ndonjë aksion kundër turqve, kurdoherë e gjenin të hapur derën e shtëpisë së Kristo Luarasit me mirëpritjen e Poliksenit, së shoqes së tij.

Në vitin 1907 lidhet me Hil Mosin dhe kërkon të organizojë një shoqëri të quajtur "Afron dita". Qëndrimi ndaj Turqve të Rinj me fytyra të reja, por ideologji të vjetër në vitin 1908 bën që ai të rikthehet në Rekën e tij,

ku nisi të organizonte arsimin.

Gjatë dy vjetëve 1909-1911 ai nxori gazetën "Shqypeja e Shqypnisë" që ishte një organ politik, i cili mbahej me ndihmat bujare të shqiptarëve dhe shpërndahej falas ndër shqiptarët e vobektë. Pavarësisht se e kanë luftuar, duke e quajtur pro-bullgare, ajo ishte një nga gazetat me progresive të kohës. Kjo gazetë përbën së bashku me përmbledhjen "Kopshti Malësor" veprën e plotë të krijimtarisë së tij.

Figura e tij me një fizik të mprehtë, të hollë, mbahet mend nga anëtarët e shoqërisë "Dëshira". Ai karakteri-

zohej nga ata si një patriot i flaktë që merrej me politike, që udhëtonte dendur në mes të Stambollit, e Bukureshtit duke shpërndare libra duke hyre fshehurazi edhe në Shqipëri për punë patriotike. Jetonte me familjen e tij, gruan dhe dy fëmijët, djalë dhe vajze, në një lagje periferike të Sofjes, të quajtur Banishora, në rrugën Bratja Milladinovi (Vellezerit Milladinov) plot me kopshte dhe shtëpi të rralla. Shumë shqiptarë porosisnin tek ai këpucët. Edhe personalitete bullgare të kohës, si poeti proletar Dimitër Poljanovi, e vlerësonte si një shqiptar të madh, burrë shumë të zgjuar.

Në 1912 pas Shpalljes së Pavarësisë ai vjen në Shqipëri pikërisht në kohën e Ismail Qemalit dhe të Princ Vidit. Një kritikë të fuqishme ai i bën Esat Pashës, intrigave të tij. Në vitin 1916, ndërmer një udhëtim heroik në kundërshtim me lutjet e familjes së tij, duke rrugëtuar më këmbë, pasi nuk kishte mjete financiare. Ky ishte rrugëtimi i tij i fundit. Mbylli sytë i sflitur dhe i vetmuar në prill të vitit 1916 në spitalin e Prishtinës, ndërkohë që një mirëdashës i mbylli sytë dhe i grumbulloi librat që kishte me vete. U varros në Kishën Ortodokse të Prishtinës, ku thuhet se gjendet edhe vendvarrimi i tij (?!...)

Çfarë ka të vërtetë mbi Trojën, tek "Iliada" e Homerit?

A kishte Homeri të drejtë? A na e rrëfeu atë që duhet? Këto pyetje i kanë ngritur shumë njerëz në kohë të ndryshme, dhe përgjigja është ende objekt debati... Por sot mund të themi se shumë nga ato që tregohen tek "Iliada", historia e rrethimit dhe rënies së qytetit të Trojës, është fryt i fantazisë. Ndonëse ka edhe diçka të vërtetë.

Fundi i një epoke

Për shembull, rënia e Trojës është histori e vërtetë. Ajo ndodhi në Epokën e Bronzit të Vonë (1300-1200 Para Erës Sonë), kur sistemi politik dhe ekonomik në rajonin e Mesdheut po transformohej, dhe tensionet, migrimet masive dhe luftërat e brendshme, përruruan nisjen e Epokës së Hekurit. Tranzicioni nuk ishte i lehtë. Shumë qytete të pasura, si Troja, Mikena dhe Tirinto, u shkatërruan dhe braktisën, dhe për to u fol për shekuj me radhë. Vetë Homeri (ose kushdo tjetër, pasi ka nga ata që dyshojnë nëse ai ka ekzistuar vërtetë) 400 vjet më vonë rrëfeu rënien e njëres prej atyre fuqive.

Qyteti tregtar

Sipas arkeologëve, Troja ngrihej jo shumë larg Çanakalës së sotme (Galipoli) në Turqi, në grykën e Ngushticës së Dardaneleve. Ajo kishte rreth 10.000 banorë, dhe ishte shumë e pasur. Grekët e lashtë e quanin Ilios, ndërsa për hititët, populli i luftëtarëve që e kontrollonin, ishte Vilusa. Për të dy, dominimi i këtij qytetit kishte rëndësi strategjike për menaxhimin e tregtisë midis Mesdheut dhe Detit të Zi.

Gjithmonë në luftë

Gjithsesi, asnjë dëshmi historike nuk konfirmon që Vilusa ra në duart e mikenasve, siç na tregon

Homeri. Shkurt, nuk ishin akejtë me në krye Agamemnonin (djalin e mbretit të Mikenës), ata që e shkatërruan atë. Megjithatë, zbulimet arkeologjike të shekullit të kaluar, kanë konfirmuar ekzistencën në Trojë të një sistemi politik kompleks, të ngjashëm me atë të përshkruar nga Homeri. Sipas disa teksteve të zbuluara në kryeqytetin hitit (Hatusha), Vilusa ishte një qytet i fuqishëm, i drejtuar nga mbreti Alaksandu, që mund të korrespondonte me princin trojan, Paridin, emri i lindjes i të cilit sipas Homerit, ishte Aleksandër. Përgjatë dekadave të gjermimeve, janë zbuluar skelete, maja shigjetash dhe gjurmë të shkatërrimit, që gjithashtu flasin për një fund të dhunshëm të qytetit dhe banorëve të tij, dhe ndoshta për një luftë tjetër.

Nuk ishte faji i një gruaje...

Nuk ishte Helena, gruaja e mbretit të Spartës, Menelaut, ajo që pasi u rrëmbye nga Paridi i Trojës, shkaktoi luftën e fundit në Ilio. Arkivat hitite, tregojnë se grekët kryen një seri fushatash ushtarake në Turqinë Perëndimore, me bastisje dhe rrëmbime të shumta njerëzish, që më pas shiteshin si skllavër. Kjo shkaktoi tensione të pashmangshme, ndoshta edhe një luftë, e cila duket e konfirmuar nga një dokument, që aludon mbi një traktat paqeje të nënshkruar rreth vitit 1200 Para Krishtit midis grekëve dhe hititëve, në lidhje me qytetin e Trojës.

Kali i Trojës

Disa nga faktet që lidhen me "Iliadën" mund të jenë trilluar ose thjesht keqkuptuar. Ka një debat të hapur mbi Mitin e Kalit të Trojës, mashtrimi i përdorur nga akejtë për të pushtuar qytetin. Në

vitin 2016, një arkeolog detar nga Universiteti i Marsejës, Francesko Tiboni, zbuloi në një studim se "kali" mund të ketë qenë në fakt një lloj anije fenikase shumë e zakonshme për kohën, e quajtur hippos (kali) për shkak të figurës së zbuluar. Nga këtu rrjedh miti apo edhe keqkuptimi i përkthyesve.

Sa vite në llogoret e luftës?

Edhe kohëzgjatja e asaj fushate të përgjakshme ushtarake, është gjithashtu objekt debatesh. Tek "Iliada" thuhet se ulje-ngritjet dhe rrethimi zgjati 10 vjet. Por për disa studiues, ai mund të ketë zgjatur shumë më gjatë, përfshirë ndoshta disa breza, aq sa të linte një ndikim të madh në imagjinatën e tyre. Përfundimisht, është e vështirë të thuhet nëse të paktën disa nga heronjtë, bëmat e të cilëve na i tregon "Iliada", kanë ekzistuar vërtet. Por në vitin 2010, profesori Atanasio Papadopoulos nga Universiteti i Janinës në Greqi, bëri një zbulim. Ai tha se bashkë me ekipin e tij të arkeologëve, kishin kryer gjermime në veri të Itakës për 16 vjet me radhë, duke gjetur mbetjet e asaj që ata besonin se ishte pallati i Ulksit, Odiseut, duke sugjeruar kështu që disa nga protagonistët e poezive homerike janë realë. Nuk përjashtohet mundësia që gjermimet e reja të zbulojnë detaje të tjera të rëndësishme, por sot për sot nuk mund të themi më shumë se kaq. Por ajo për të cilën bien të gjithë dakord, është vlera e madhe e këtyre poezive, deri në pikën që edhe poeti i madh italian Xhakomo Leopardi tha se "gjithçka është përsosur që nga koha e Homerit e më vonë, por jo poezia". /Focus-Bota.al/



NË AMBIENTET E REPARTIT 1050, ZALL-HERR, TIRANË

Trupat shqiptare dhe britanike në stërvitjen "Rural Surveillance and Patrol Training"

